

VENDIM
Nr. 53, datë 1.2.2023

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË AKORDIMIT TË FONDEVE PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE DHE REHABILITUESE NDAJ FATKEQËSIVE, NË INFRASTRUKTURËN E DËMTUAR, SI EDHE NË VEPRIMTARI TË TJERA NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të pikës 6, të nenit 23, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (në vijim AKMC), në kuadrin e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, planifikon në buxhetin vjetor të saj fonde për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile.

2. Fondet e planifikuara nga AKMC-ja për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile akordohen, bazuar në këto dokumente orientuese:

a) Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror dhe vendor;

b) Vlerësimin e riskut në nivel qendror dhe vendor;

c) Planin Kombëtar për Emergjencat Civile në nivel qendror dhe vendor.

3. AKMC-ja është institucioni përgjegjës për hartimin dhe miratimin e urdhrave për akordimin e fondeve të planifikuara në buxhetin vjetor të saj, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

4. Fondet e planifikuara, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i akordohen njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, kur:

a) nevojitet kryerja e shpenzimeve shtesë për përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë;

b) kostoja e ndërhyrjes tejkalon buxhetin vjetor të dedikuar për mbrojtjen civile.

5. Për përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e përcaktuara në pikat 9 dhe 10, të nenit 3, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dokumentacioni për akordimin e fondeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore me destinacion sigurimin e kushteve të përkohshme për jetesë të qytetarëve, si dhe për shpenzime të tjera, duhet të përbëhet nga:

a) kërkesa e argumentuar nga kryetari i bashkisë, ku të përfshihet destinacioni i përdorimit të fondit, shoqëruar me preventivat dhe projektet, sipas rastit;

b) miratimi i kërkesës nga prefekti i qarkut, duke dhënë dhe argumente shtesë për nevojën e mbështetjes financiare.

6. Dokumentacioni i hartuar sipas pikës 5, të këtij vendimi, dërgohet nga prefekti i qarkut pranë AKMC-së, e cila shqyrton kërkesën dhe kthen përgjigje brenda 2 ditësh nga marrja e kërkesës.

7. Për akordimin e fondeve me destinacion marrjen e masave parandaluese mbrojtëse, të përgjigjes, të rehabilitimit dhe të rimëkëmbjes për infrastrukturën publike në përgjegjësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duhet të hartohet dokumentacioni, i cili përbëhet nga:

a) kërkesa e njësisë së vetëqeverisjes vendore për fonde shtesë, drejtuar prefektit të qarkut;

b) vendimi i këshillit bashkiak, ku të përcaktohet destinacioni i përdorimit të fondit të kërkuar për emergjencën civile;

c) projekti i zbatimit i shoqëruar me dokumentacionet përkatëse, i cili, sipas rastit, mund të hartohet nga subjekte shtetërore dhe/ose private të licencuara;

ç) konfirmimi nga prefekti i qarkut i ligjshmërisë së vendimit të këshillit bashkiak, i shoqëruar me argumente të tjera shtesë, për mbështetjen financiare;

d) kërkesa e argumentuar nga prefekti i qarkut, drejtuar AKMC-së, për nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes në objektet e dëmtuara.

8. Dokumentacioni i hartuar sipas pikës 7, të këtij vendimi, dërgohet nga prefekti i qarkut pranë AKMC-së, e cila shqyrton kërkesën dhe kthen përgjigje brenda 45 ditësh nga marrja e kërkesës.

9. Fondet e akorduara njësisë të vetëqeverisjes vendore administrohen nga këto të fundit, sipas destinacionit të përcaktuar në urdhrin e nxjerrë nga AKMC-ja, për këtë qëllim.

10. Prefekti i qarkut siguron dhe kontrollon zbatimin e urdhrin të nxjerrë nga AKMC-ja për akordimin e fondit njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe mënyrën e administrimit të tij, sipas destinacionit të përcaktuar.

11. AKMC-ja për fondet e akorduara njësisë të vetëqeverisjes vendore për parandalimin, rehabilitimin ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, ushtron kompetencat për inspektim, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Ngarkohen ministri përgjegjës për mbrojtjen civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, prefekti i qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama